



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:010533

Datë: 01.02.2022

Numri i dokumentit: 02668391

CPP.nr.10/22

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE-DEGA NE VUSHTRRI, Departamenti i pergjithshem – Divizioni Civil, si permbarimore e perbere nga Gjykatesi Individual Besnik Feka ne ceshtjen juridike te kreditorit Sh.A “K.” M. me seli ne M., kunder debitorit Sh. H. nga V. per shkak te borxhit ne shume prej **1,799.00**, gjykata, duke vendosur sipas prapesimit te debitorit ushtruar kunder Urdherit per Lejimin e Permbarimit, gjykata jashte seances me daten **01.02.2022**, nxjerr kete:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET PJESERISHT prapesimi i debitorit Sh. H. nga V., ashtu qe: **SHFUQIZOHET PJESERISHT** Urdheri per Lejimin e Permbarimit **P.nr.1312/21, dt:13.08.2021**, per periudhen kohore 31.03.2016 e gjer me 31.12.2019, ashtu qe, **OBLIGOHET** debitori Sh. H. nga V. qe ne emer te borxhit per konsumin e ujit, per periudhen kohore 01.01.2020 e gjere me 31.07.2021 kreditorit Sh.A “K.” M. me seli ne M., t’ia paguaje shumen prej **237.58 me kamate ligjore prej 8% vjetore**, duke filluar nga data e ushtrimit te propozimit 13.08.2021, e deri ne pagesen definitive te borxhit.

A r s y e t i m

Kreditori Sh. A “K.” M. me seli ne M., ka parashtruar propozim per lejimin e permbarimit, kunder debitorit Sh. H. nga V. per borxhin ne emer te konsumit te ujit ne shume prej **1,799.00 euro**, per periudhen kohore 31.03.2016, e gjer me 30.07.2021, githmone referuar ekstraktit te prezentuar nga kreditori.

Permbaruesi Privat ka lejuar permbarimin sipas propozimit te kreditorit.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapesim duke e kundershtruar ne teresi borxhin e kreditorit, me arsyetimin se borxhi eshte i parashkruar konform nenit 360, te LMD-se, ka propozuar qe propozimi te refuzohet.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar pergjigjje ne prapesimin e debitorit, duke i kundershtruar pretendimet e debitorit ne prapesimin e ushtruar dhe duke i propozuar gjykates qe prapesimin ta refuzoi ne teresi.

Gjykata, pas shqyrtimit te prapesimit dhe pergjigjjes ne prapesim, gjeti se prapesimi I debitorit eshte pjeserisht I bazuar, sa i perket borxhit te kreditorit te pretenduar ne raport me debitorin, ne shume prej **1,561.42 euro** nga dt: 31.03.2016 e deri me dt: 31.12.2019, i njejt i eshte borxh i vjetërsuar, konform nenit 360, par.1, ku parashihet **“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti”**, ndersa ne nenin 360, par.1, ne nenpar.1.1, te Ligjit per Marredheniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, ne te cilin percaktohet **“kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”**, ndersa sa i perket rrjedhjes se afatit te parashkrimit, ne nenin 360, par.2 te te njejt ligj parashihet **“Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”**, pasiqe, kreditori propozimin per permbarim e ka parashtruar ne vitin 2021, dhe ka nderprere rrjedhjen e afatit te parashkrimit nga data 01.01.2020 e gjer me datën e kërkuar te detyrimit 31.07.2021, ashtu qe, shuma e detyruar per debitorin si ne piken **I** te dispozitivit, duhet te paguhet nga debitori prej **237.58 euro**, duhet te permbushet, ngase gjen mbështetje ne nenin 8 dhe 245 par.1 te Ligjit per Marredheniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 ne te cilin theksohet citoj **“ Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë**

*për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”, po ashtu ne nenin 245, par.1 te të njëjtit ligj parashihet citoj “ **Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij, Detyrimi mund të shuhet vetëm me pajtimin e vullneteve të pjesëmarrësve në marrëdhënien e detyrimeve ose në bazë të ligjit”.***

Po ashtu, meqenëse u konstatua gjate kësaj periudhe nuk ka prova se palët kane lidhur marrëveshje per riprogramim te borxhit qe do te shkaktonte ndërprerjen e rrjedhjes se afatit te parashkrimit, dhe nuk ka prova se kreditori ka ndermarre ndonjë veprim ligjor kundër borxhit te debitorit qe do te shkaktonte ndërprerjen e rrjedhjes se afatit te parashkrimit per periudhën gjegjëse kohore, iu referua aktgjykimit te Gjykates Supreme **Rev.nr. 148/2012, dt: 09.09.2013 (faqja 3, pasuesi i katërt i aktgjykimit)**, ku parashihet se pagesat eventuale qe jane bere per kete periudhe nga debitori ne forme te ndonjë pagese ne këste nuk shkaktojnë ndërprerjen e rrjedhjes se afatit te parashkrimit, poqese ato nuk i referohet ndonjë pagese te ndonjë fature fikse per muajin gjegjes, përveç nëse mes paleve ka marrëveshje per riprogramim te borxhit apo ka specifikime te kërkesës per te cilën behet pagesa qe ne rastin konkret nuk ekzistojnë, e te cilat, konform nenit 368, par.1 dhe 2 te Ligjit per Marredheniet e Detyrimeve, do te rezultonin me ndërprerjen e rrjedhjes se afatit te parashkrimit per debitorin. Pagesat e kohëpaskohshme qe debitori ka paguar ne emër te borxhit si tërësi nuk nënkupton pohim i borxhit per vet faktin se i njëjti me prapësimin e ushtruar ka kundërshtuar ne tërësi borxhin e te njëjtat pagesa nuk jane këste te paguara mbi bazën e ndonjë marrëveshje, ashtu qe, keto pagesa paushallë nuk kane shkakuar ndërprerjen e afatit te parashkrimit per debitorin ne rastin konkret. Pohim indirekt (jo deklarativ) te borxhit, sipas vleresimit te kësaj gjykate, kemi atëherë, kur debitori hyn ne marrëveshje riprogramimi me kreditorin dhe përcakton afate te reja kohore dhe periudha ne këste te caktuara per përmbushjen e borxhit ne tërësi apo pjeserisht. Njeashtu edhe me qendrimin e mbajtur te Gjykates Supreme te Kosoves ne aktgjykimin **Rev.nr.211/2019, dt:13.08.2019**, e njejta ka mbajte qendrimin se pohimi i bazez juridike te detyrimit pa pohimin e sakte, konkret dhe te qarte te lartesis se detyrimit nga debitori (apo i padituri) nuk konsiderohet pohim i borxhit nga debitori, qe do rezultonte me ndërprerje te rrjedhjes se afatit te parashkrimit sipas nenit 368 par.1 te LMD-se. Pagesat paushalle te detyrimit nuk konsiderohen pagese e kesteve dhe nuk rezultojne me ndërprerje te rrjedhjes se afatit te parashkrimit sipas nenit 368 par.2 te LMD-se, si menyre e terthorte e ndërprerjes se rrjedhjes se parashkrimit.

Gjykata, lidhur me kamatën ligjore, iu referua nenit 382, par.1 te Ligjit per Marredheniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, ne te cilin parashihet “**Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën**”, ndersa referuar nenit 382, par.2 te këtij ligji parashihet lartësia e kamatvoneses, ne te cilin thuhet “**Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj te veçante**”, poashtu sa i përket afatit te rrjedhjes se kamatëvonesës i referohet mendimit juridik te Gjykates Supreme te Kosoves nr. 265/20, dt: 01.12.2020, respektivisht par. II, III dhe VI te këtij mendimi, gjykata gjeti se debitori ka rene ne vonese ne permbushjen e detyrimit ndaj kreditorit nga data kur eshte ushtruar propozimi per permbarim e tutje.

Prandaj, gjykata, bazuar ne nenin 43 par.4, ne lidhje me nenin 71 dhe 73 te Ligjit per Procedure Permbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit eshte pjesërisht i bazuar, prandaj, edhe vendosi si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE-DEGA NE VUSHTRRI
Departamenti i Pergjithshem-Divizioni Civil
CPP. Nr.10/22, dt: 02.01.2022

GJYKATESI
Besnik Feka

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kunder ketij aktvendimi, lejohet e drejta ne ankese, ne afat prej 7 ditesh, nga dita e pranimit te ketij aktvendimi, Gjykates se Apelit ne Prishtine. Ankesa ushtrohet permes kesaj gjykate.